



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2021:205394
Datë: 04.03.2024
Numri i dokumentit: 05406118

CP.nr.1563/21

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtari Sami Gashi, me zyrtaren ligjore Raxhije Emini, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit, R.K., M.F., B.Sh., P.A., D.K., të gjithë nga Prizreni, të cilët me autorizim i përfaqëson, av. Sh.A., nga Mitrovica, kundër debitorës, Universiteti i Prizrenit “UKSHIN HOTI” – Prizren, për shkak të detyrimit në të holla në shumën prej 2,501.90 €, me kamatë ligjore të llogaritura nga eksperti financiar, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore shumën prej 1,558.80 euro, i lejuar me aktvendimin e kësaj gjykate, CP.nr.1563/21 të dt.16.11.2021, duke vendosur për debitimin e mjeteve përmes xhirollogarive bankare, jashtë seancës gjyqësore, me dt.04.03.2024 mori këtë:

A K T V E N D I M

I. URDHËROHET Ministria e Financave e Republikës së Kosovës në Prishtinë, Llogaria e vetme e Thesarit, që në emër të detyrimit të përcaktuar me aktvendimin e kësaj gjykate, CP.nr.1563/21 të dt.16.11.2021, për lejimin e përmbartimit të dokumentit të përmbartimit Aktgjykimit të plotfuqishëm dhe të ekzekutueshëm të Gjykatës Themelore në Prizren, të datës 01.07.2021, të bëjë debitimin e mjeteve monetare në emër të detyrimit në shumën prej **2,501.90 €**, me kamatë ligjore, shpenzimet e procedurës kontestimore shumën prej **1,558.80 euro**, në emër të shpenzimeve të procedurës përmbartimore shumën prej, **988.00 euro**, e në shumën e përgjithshme për pagesë **5,048.00 €**, në atë mënyrë që nga xhirollogaria bankare e debitorit, Universiteti i Prizrenit “UKSHIN HOTI” – Prizren, e cila gjendet te BQK-ja me seli në Prishtinë, t’i bart këto mjetet monetare, në dobi të autorizuarave të kreditorëve, av. Sheremet Ademi nga Mitrovica me nr. Personal 1006859590, në xhirollogarinë e tij bankare me **nr.1305001001452573**, aktive në Banka Për Biznes- BPB-Bankë.

II. OBLIGOHET av. Sh.A., nga Mitrovica dhe Ministria e Financave e Republikës së Kosovës – Llogaria e vetme e Thesarit në Prishtinë, që gjykatën t’u njoftoj me shkrim për zbatimin e këtij aktvendimi ose për arsyet e mos zbatimit të tij.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prizren, me aktvendimin e saj, CP.nr.1563/21 të dt.16.11.2021, ka lejuar propozimit për përmbartim të kreditorëve: R.K., M.F., B.Sh., P.A., D.K., të gjithë nga Prizreni, të cilët me autorizim e përfaqëson, av. Sh.A., nga Mitrovica, të paraqitur kundër

debitoit, Universiteti i Prizrenit “UKSHIN HOTI” – Prizren, për dokumentin përmbarues Aktgjykimit të plotfuqishëm dhe të ekzekutueshëm të Gjykatës Themelore në Prizren, të datës 01.07.2021 në emër të kompensimit të pagave jubilarë në shumën prej 2,330.59 euro, me kamat ligjore prej 8%. Pala debitore pas pranimit të këtij aktvendimi CP.nr.1563/21 të dt.16.11.2021 për lejimin e përmbarimit, nuk ka paraqitur prapësim dhe ky aktvendim është bërë i përmbarueshëm dhe i formës së prerë në procedurën e përmbarimit, meqenëse pala kreditore në propozimin për përmbarim, ka cekur mjetin e përmbarimit, transferimin e mjeteve monetare përmes xhirollogarive bankare me qëllim të realizimit të detyrimit në të holla, pas shqyrtimit të të gjitha shkresave të lëndës, kjo gjykatë gjeti se duhet të bëhet debitimi i mjeteve monetare në emër të kompensimit të pagave jubilarë me kamatë ligjore prej 8%, përmes xhirollogarive bankare.

Me shikim në shkresat e lëndës, kjo gjykatë ka gjetur se pjesë e detyrimit që rrjedh nga dokumenti përmbarues Aktgjykimit i plotfuqishëm dhe i ekzekutueshëm i Gjykatës Themelore në Prizren, është kompensimi në të holla i përshkruar si më lartë, për realizimin e kredisë në të holla kundër debitorës së përmbarimit, debitimin e mjeteve financiare përmes xhirollogarive bankare, në kuptim të nenit 152 të LPP-së, dhe duke u bazuar në dokumentin e përmbarimit, debitori, Universiteti i Prizrenit “UKSHIN HOTI” – Prizren, është e obliguar që kreditorve: R.K., M.F., B.Sh., P.A., D.K., të cilët me autorizim i përfaqëson, av. Sh.A., nga Mitrovica, t’iu paguaj mjetet monetare në emër të pagave jubilarë në shumën prej 2,330.59 euro, si dhe kamatën ligjore prej 8% të llogaritura nga ekspertiza e ekspertit financiar shumën prej 572.31 euro, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore shumën prej 1,558.80 euro. Po ashtu kjo gjykatë gjen se sa i përket shpenzimeve të përmbarimit, të njëjtat palës kreditore, të autorizuarit të tyre duhet t’i njihen dhe atë për përpilimin e propozimit për përmbarim shumën prej 468.00 €, për taksën gjyqësore shumën prej 30.00 €, për përfaqësimin në një seancë shumën prej 390.00 €, dhe shpenzimet për ekspertizë shumën prej 100.00 €, e në shumën e përgjithshme prej 988.00 €, të paraparë sipas Tarifës së Odës së Avokatëve, andaj nga arsyet e cekura më lartë kjo gjykatë vendosi që të urdhëroj Ministrinë e Financave me seli në Prishtinë - Llogarinë e Thesarit, që të bëjë debitimin e mjeteve monetare, e më gjerësisht me përshkrimin e bërë si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prandaj, nga ajo që u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi e në kuptim të nenit 3, 5 par.6 pika 2, 13 par.4, 17, 21, 22, 24, 109 par.3, 113, dhe nenin 152 të LPP-së, e lidhur me nenin 449, 452, 453 dhe nenin 463 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti i Përgjithshëm
CP.nr.1563/21
Datë 04.03.2024

Zyrrarja ligjore,
Raxhije Emini

Gjyqtari
Sami Gashi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi nuk lejohet ankesë.